



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 02.05.2019, e cila
fillooi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkyretar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkyretar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Uran Ismaili (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Para se të fillonin me diskutimet rrëth rendit të ditës, Kryesuesi i ftoi anëtarët e rind të Kuvendit që ta bëjnë betimin.

Hafiz Krasniqi (LDK) dhe Arbër Vokrri (LVV) e bënë betimin para Kuvendit.

**Migjen Shala propozoi që në rend të ditës të futet si pikë "Emërtimi i parkut me emrin e dëshmorit Mentor Retkoceri", që gjendet në mes të lagjeve "Ulpiana" dhe "Dardania".
Kryesuesi e hodhi në votim propozimin.**

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 1 kundër, futet në rend të ditës për diskutim propozimi i dhënë nga z. Shala.

Naime Osmani propozoi që në rend të ditës të futet "Formimin i komisionit për emërtimin dhe rishqyrtimin e emrave të rrugëve", pasi që kemi shumë ankesa nga qytetarët. Me përfundimin e mandatit të mëhershëm të Kuvendit, ka përfunduar edhe mandati i atij komisioni.

Osman Bllaca tha se në bazë të Ligjit për emërtim të adresave, kërkohet që pas emërtimit dhe vendimit final të Kuvendit komunal, brenda 5 vjetëve mos me pasur të drejtë me u emërtuar rrugë të tjera, kështu që vendimi i fundit është marr në vitit 2015 dhe deri në vitin 2020 nuk mund të formojmë komision për emërtim të rrugëve.

Nol Nushi tha se jam i pajtimit që ta formojmë një komision për emërimin e rrugëve, ashtu si ka qenë ai i mëhershmi, por ta bëjmë një komision jo formal, ose një far komisioni procedural, që të paktën i procedon të gjitha propozimet që i kanë, qoftë grupet e asamblistëve, qoftë grupet e qytetarëve, ose propozimet që vijnë prej shoqërisë në përgjithësi.

Agim Gashi tha se çdo propozim i dhënë për emërtime të reja, paraprakisht kërkesat adresohen në komision, komision i shqyrton, pastaj në harmonizimin me qeverinë komunale kërkesat futen në rend të ditës në Kuvend për shqyrtim. Mendoj se këtë procedurë e rregullon ligji. Nuk e besoj se ka ligj që për 5 vjet e ndalon formimin e një komisioni të tillë.

Egzon Azemi kërkoi nga Kuvendi i Komunës që t'i bëhet kërkesë Agjencisë Kundërkorrupsion për shqyrtimin e të gjitha rasteve të konfliktit të interesit të anëtarëve të Kuvendit komunal. Këtë e potencoja nga fakti se ne e kemi marrë një e-mail anonim, ku në të thuhet se nga Agjencia Kundërkorrupsion është kërkuar që të trajtohen disa raste për konflikt interesit në Kuvendin komunal të Prishtinës. Në atë e-mail specifikisht përmenden disa asamblistë, një ndër ta është edhe Blerand Stavileci, ku specifikohet se mund të ketë konflikt interesit, sepse, siç dihet, ai është drejtor i Klubit Prishtina, e gjithashtu është edhe asamblist. Propozoj që këtë ta fusim në rend dite.

Nol Nushi tha se ne nuk e dimë që ka konflikte të interesit, është vetëm pretendim. Në emër të grupeve parlamentare, kryesuesi mund ta dërgojë një njoftim – e-mail te Agjencia Kundërkorrupsion, që t'i verifikojë të gjithë asamblistët e Komunës së Prishtinës se a kanë apo nuk kanë konflikt interesit me pozitën që ata mbajnë.

Halim Halimi tha se sa i përket formimit të një komisioni, do të ishte i mirëseardhur, sepse kemi shumë kërkesa të qytetareve të komunës së Prishtinës, ngase shumë rrugë dhe sheshe janë të paemërtuara. Por mos të shkojmë të qesim pika të rendit të ditës pa zhvillimin e procedurave nëpër drejtoritë, nëpër komisione, ngase ne këtu në Kuvend marrim një vendim, mirëpo më vonë drejtoritë kanë probleme rrith projekteve të tillë. Formimi i këtij

komisioni është më se i nevojshëm për me i propozuar emërimet e rrugëve, shesheve, vendbanimeve e tjera.

Shefki Gashi shprehu mendimin se kur është formuar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera ndihmëse, është dashtë të formohet edhe Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve, vendbanimeve, dhe është i obliguar me ekzistuar pran Kuvendit komunal të Prishtinës. Nëse Ministria ka nxjerrë një ligj që për 5 vjet nuk mund të formohet një komision i tillë, është diçka paradoksale dhe është e pa pranueshme. Prishtina për çdo vit ka me dhjetëra rrugë të reja, të cilat duhet të emërtohen, sepse humbin adresat, nuk dihet ku janë.

Ai e përkrahu kërkesën e znj. Naime Osmani, që të emërtohet komisioni valid, si trupë ndihmese e Kuvendin për emërtimin e rrugëve dhe vendbanimeve.

Eman Rahmani tha se nëse formohet një komision dhe i jepet e drejta atij që t'i shqyrtojë edhe kërkesat e shumta që ka për qëllim ndërrimin e emrave të disa rrugëve ekzistuese, mendoj se do të shkaktojë një kaos. Nëse merret një vendim për formimin e një komision të tillë, paraprakisht duhet me u marrë një vendim që rrugëve ekzistuese mos me iu ndryshuar emri për një periudhë kohore. Kështu që edhe te rasti për emërtimin e parkut që u propozua më parë, ne e mbështesim, mirëpo nëse formohet komision, duhet të kemi shumë kujdes, për shkak se mund të bëjmë një çrregullim në komunën e Prishtinës.

Fikneta Bejta tha se si pasojë e moszbatimit të disa kritereve gjatë emërtimit të rrugëve në të kaluarën, dhe mos akordimin me banorët e pjesëve ku janë emërtuar këto rrugë, kanë hasur në probleme të mëdha, dhe si pasojë e kësaj kemi shumë kërkesa edhe ne si asamblistë, çdo ditë ballafaqohemi me kërkesa të tillë për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve. Në emër të grupit të asamblistëve të AAK-së, e përkrahim idenë e zonjës Naime Osmani, që të formojmë një komision jo formal ose procedural, me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve parlamentare, që të merret me këtë problematikë, pasi që çdo ditë ne kemi kërkesa të tillë.

Vlora Dumoshi tha se ne nuk mundemi në mënyrë arbitrale me emërtuar rrugë, gjithmonë kanë ekzistuar komisionet. Komisionet nuk munden me u bërë prej këtij Kuvendi, por ky Kuvend mundet me i miratuar emrat e propozuar nga ai komision, i cili komision ka përbërje tjetër, ka historianë, ka njerëz të cilët janë të profileve të ndryshme, gjithsesi edhe përfaqësues të Kuvendit, të partive këtu qe jemi pjesë e Kuvendit.

Për 5 vjet me u ndalu dhe mos me u formuar një komision i tillë, mendoj se është e papranueshme. Prishtina për çdo ditë rritet, kemi rrugë të cilat duhet të emërtohen, kështu që me e ndaluar në mënyrë arbitrale për 5 vjet formimin e komisionit, mendoj se kjo nuk është e drejtë.

Fatos Dibra, zyrtar ligjor, tha se afati 5-vjeçar është prej asaj listës rezervë që e ka miratuar Kuvendi, që është një procedurë tjetër. Nuk ka afat 5-vjeçar për mos me bërë komision tjetër, komisioni e ka vendimin, mundet edhe ai komision që ka qenë me e vazhduar punën, atij komisioni nuk i ka përfunduar mandati.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe ish-zyrtar ligjor, tha se edhe më herët këtu në Kuvend është propozuar me bërë një komision, ku do ta rishqyrtonde procesin prej fillimit, por unë e kamë kundërshtuar, me arsyetimin se emërtimi i rrugëve bëhet një herë, pra është proces që bëhet njëherë dhe krijohet sistemi i adresave, dhe ai sistem duhet me qenë i besueshëm, nuk është mirë me u ndërruar adresat shpesh.

Lista rezervë rishqyrtohet çdo 5 vjet dhe emri i rrugës mundet me u ndryshuar me kërkësë të banorëve, por emri tjetër merret nga lista rezervë.

Sami Boroci u deklarua për formimin e një komisioni të tillë, po jo sot. Ai tha se ne duhet me e përcaktuar shumë qartë se cili ka me qenë mandati i këtij komisioni, çfarë roli do të ketë, çfarë koherence do të ketë. Nuk mendoj se ky komision duhet me pasur mandatin me i riemërtuar edhe një herë të gjitha rrugët.

Ai propozoi që për mbledhjen e radhës, cilido nga anëtarët e Kuvendit që e parashtron këtë çështje, të kërkojë prej ekzekutivit që propozimin ta parashtrojë në Kuvend.

Fadil Gashi shprehu mendimin që të shkarkohet komisioni që ka bërë emërtimin e rrugëve, pasi që nuk kanë punuar asnjë drejt, vetëm kanë vënë emra të rrugëve që as vetë nuk i njohin, prandaj kërkesa e AAK-së është që të shkarkohet ky komision.

Drilon Pireva tha se nëse ne e votojmë formimin e një komisioni të ri, ai nuk ka të drejtë të bëjë riemërtim të rrugëve, mund të bëjë vetëm emërtime të reja të rrugëve. Ne do të duhej ta iniciacionim një grup nga anëtarët e Kuvendit për t'i propozuar anëtarët e komisionit, e që ky komision do të duhej t'i emërtonte rrugët dhe sheshet me emrat e ri të njerëzve që kanë vdekur, d.m.th. është rasti i Adem Demaçit e raste të tjera. Po ashtu, ky komision do të duhej ta vlerësonte edhe propozimin e emrit të dëshmorit që ne sot e votuam për emërtimin e parkut në mes të lagjes "Ulpiana" dhe "Dardania". Aty është një park, një qosh i vogël, ku nuk e dimë a ishte dashtë ky park me pasur emrin e atij dëshmori.

Rifat Deri tha se këtij komisioni mandati i përfundon në tetor të këtij viti, por pse me pritur ne me kaluar afati, kur Kuvendi ka të drejtë me e shkarkuar këtë komision, me propozuar një komision të ri, i cili do të ishte i përberë prej profesionalistëve të të gjitha fushave dhe njohës të qytetit të Prishtinës. Ne duhet ta kemi parasysh që Prishtina është kryeqytet, duhet me pasur emra edhe prej qyteteve të tjera. Besoj dhe jam shumë i bindur që respektin ma të madh duhet të tregojmë për qytetarët e Prishtinës. Kemi pasur shumë vërejtje këtu, se janë vendosur emrat e rrugëve nëpër fshatra, nëpër pjesë të qytetit, ku vetëm qytetarët që jetojnë aty e kanë parë emrin dhe nuk e dinë kush është, çka është! Mendoj se emërtimet e rrugëve janë bërë në mënyrë jo të drejtë dhe nuk e paraqesin komplet edukatën, kulturën dhe historinë e komunës së Prishtinës.

Kryesuesi pyeti se a mund të pajtohem, që pas mbledhjes me e mbajtur një takim me shefat e grupeve parlamentare, me diskutuar bashkë me përfaqësuesin e Zyrës ligjore, me të gjithë ata që kanë informacione, në mënyrë që për mbledhjen e radhës me ardhur dhe me qenë të

gjithë të një mendimi. Mbetet që të hënën me shefat e grupeve parlamentare dhe me zyrtarin ligjor, të merret një qëndrim se si ta procedojmë këtë çeshtje.

Eman Rrahmani ngriti një çeshtje rreth mungesës në pjesëmarrje të seancave të Kuvendit për 6 mbledhje radhazi, të znj. Visare Gorani. Ai kërkoj sqarim nga kryesuesi për mungesat e saj. Nga kryesuesi ai kerkoi që ta dërgojë kërkesën bashkë me arsyetimin, për me e vlerësuar arsyetimin se a ka bazë për t'u zëvendësuar me asamblistë që janë duke pritur në radhë për përfaqësim të qytetarëve.

Visare Gorani - Gashi tha se arsyetimet për mungesat e mijë i kam dërguar në rrugën zyrtare, ku kam informuar për shkaqet që nuk kam qenë. Nuk e kamë ndërmend me dhënë ndonjë shpjegim të veçantë, por kryesuesi i ka marrë informimet në kohën e duhur.

Eman Rrahmani kerkoi nga kryesuesi që bashkë me arsyetimin, t'i dërgojë në organet kompetente për të vlerësuar se a janë të arsyeshme mungesat. Nëse jo, atëherë merret vendimi për zëvendësimin e saj.

Migjen Shala tha se ne nuk mundemi me ia mohuar asnjë asamblisti mos me propozuar emrin e një heroi apo dëshmori. Këtë propozim e kam dhënë si individ, si asamblist, jo si grup, se ne nuk guxojmë me pasur dallime në këtë drejtim. Sa i përket komisionit, jam për formimin e një komisioni të ri, që t'i shqyrtojë emërtimet e disa rrugëve, si p.sh. në fshatin Trudë ka emra sllav. Ai komision ka dështuar, meriton me u ndëshkuar, pra dhe të largohen të gjithë ata emra të rrugëve që nuk lidhen me çeshtje kombëtare, me neve, me kombin tonë.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 41 vota për dhe 2 abstenime, u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për emërtimin e parkut "Mentor Retkoceri", në mes të lagjeve "Ulpiana" dhe "Dardania";
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM 1);
4. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);

7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Azemine (Hamit) Gashit;
11. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
12. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);
13. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;

Kryesuesi konstataoi se më 36 vota për dhe 2 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për emërtimin e parkut "Mentor Retkoceri", në mes të lagjeve "Ulpiana" dhe "Dardania".

Kryesuesi konstataoi se më 36 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për emërtimin e parkut "Mentor Retkoceri", në mes të lagjeve "Ulpiana" dhe "Dardania".

Pika e tretë

Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM 1).

Kryesuesi hapi diskutimin.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se gjatë kësaj periudhe raportuese Komuna e Prishtinës ka bërë realizimin e të hyrave vetanake në vlerë prej 6 milionë 744,6879 euro, apo 20.41% e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2019, kurse krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, kemi pasur një rritje prej 17.28% të të hyrave vetanake. Sa i përket shpenzimeve për këtë përudhë raportuese të vitit 2019, ato janë 12 milionë e 272,712 euro, apo 11.05% e buxhetit të vitit 2019, kurse krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, kemi një rritje të shpenzimeve prej 9.86%.

Tek rapporti janë paraqitur disa shpenzime, por ato projekte janë të vitit 2018, për ato projekte që janë të bartura ose të planifikuara për 2019. Në këtë periudhë tremujore për projektet e vitit 2019, që gjithsej janë 126 projekte kapitale, duke i përjashtuar ato kontrata kornizë.

Halim Halimi tha se rapporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës së Prishtinës për tremujorin e parë të këtij viti, ka përfshirë arkëtimin, shpenzimet, investimet dhe detyrimet. Nëse e shikojmë këtë raport në dukje të parë, sa i përket aspektit të të hyrave, mund të themi që është mirë, por nuk është mirë, ngase planifikimi ka qenë shumë i vogël dhe është dashtë të jetë një planifikim më i madh. Në këtë tremujor janë arkëtar diku mbi 6 milionë euro. Është shqetësuese te shpenzimet, sidomos te shpenzimet kapitale, nëse kanë qenë të planifikuara shpenzimet kapitale në shumën prej 48 milionë 358,000 euro, janë shpenzuar në ketë tre mujor vetëm 1 milion e 25,000 euro, do të thotë ku është puna e këtij ekzekutivi! Nga kjo mund të konstatojmë se nuk është bërë një punë cilësore, të cilën e presin qytetarët e komunës së Prishtinës, dhe nëse vazhdon me një trend të tillë të shpenzimeve kapitale, do të na mbesin bartje. Krahasuar me periudhën paraprake, arkëtimet janë gjithherë e më të vogla në krahasim me arkëtimet e mëparshme. Shikuar në përgjithësi, në asnjë drejtori nuk është shpenzuar nga ajo që kanë qenë të parapara me projekt. Po ashtu, kemi edhe drejtori me zero shpenzime, pra kjo do të thotë se nuk është menaxhuar mirë me paranë publike.

Mirsad Vitia tha se sipas të dhënave që paraqet ky raport, nëse krahasojmë me TM-1 e vitit 2018, shihet se ka një përmirësim të të hyrave tatimore dhe jo tatimore, me një rritje mbi 17%, por duhet të theksohet se kjo rritje është shtyrë në masë të madhe, sidomos nga të hyrat nga mbeturinat, afér 334.000 euro më shumë se viti i kaluar, Inspeksioni rrëth 165% me tepër se në 2018, infrastruktura rrugore 338.000 euro më shumë këtë vit, dhe gjobat nga trafiku 122% apo 296.000 euro më shumë të hyra sesa viti paraprak. Përkundër kësaj, në anën tjetër kemi një renie të të hyrave vetanake për disa kategoritë të rëndësishme. Pra, kemi pasur ulje drastike, mbi 92%, sa i përket donacioneve. Po ashtu, kemi një renie të të hyrave nga tatimi në pronën e paluajtshme.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore për kategoritë "Paga dhe mëditje", "Mallra dhe shërbime" dhe "Shpenzime komunale", mjerisht ende çalon tek ajo më e rëndësishmja "Shpenzimet kapitale", me një rritje për vetëm 2%.

Në disa drejtori komunale, si Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Planifikimi Urban, Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Sportit shënojnë 0% progres gjatë TM-1 2019. Po ashtu, edhe drejtoritë e tjera shënojnë një progres shumë të vogël në realizim të buxhetit.

Fatkeqësish, kjo qeverisje komunale ose ka keqplanifikuar buxhetin vjetor, ose nuk është e zonja ta zbatojë atë në praktikë me njerëz joprofesional. Kjo ngase për çdo vit asaj po i teprojnë me miliona euro, përderisa nevojat e qytetarëve vazhdojnë të mos jetësohen.

Fiknete Bejta tha se rapporti i tremujorit të parë buxhetor, janar- mars 2019, tregon për një rritje të të hyrave vetanake të Komunës për 17.28% dhe kjo rritje ka rezultuar nga realizimi i të hyrave për taksat nga transaksi i një pronë dhe nga infrastruktura rrugore. Pra, ka një performancë të mirë financiar në aspektin e të hyrave financiare. Gjithashtu kemi një rritje të

shpenzimeve buxhetore, sidomos rritje te kategorite e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime" për 22.92%, nëse e krahasojmë me vitin dhe periudhën paraprake.

Ky raport tregon për performancë të dobët lidhur me shpenzimet te kategoritë e shpenzimeve kapitale për vetëm 2.12% të planit, edhe pse në krahasim me vitin 2018 ka rritje të theksuar. Vlen të theksohet se i gjithë rapporti e konteston suksesin e Komunës së Prishtinës në investime kapitale. Tek shpenzimet në projektet kapitale ka me shumë aktivitete të prokurimit. Në këtë tremujor vlen të theksohet realizimi i shpenzimeve në aspektin e shpenzimeve në projekte kapitale, e që kampion i realizimit të shpenzimeve është Drejtoria e Parqeve dhe Drejtoria e Administratës.

Po ashtu, mund të theksoj një trend pozitiv te realizimet praktike, ose të ardhurat faktike, që shohim një gjendje të mirë te të ardhurat faktike të identikuara sipas llojit të organizatave buxhetore, të krahasuara me përshkrimet përkatëse të cilat janë përfshirë në buxhet.

Vlen të theksohet se kemi shpenzime më të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar, mirëpo ka ngecje te shpenzimet për investime kapitale. Kërkoj nga ekzekutivi të ushtrojë kontroll më të madh dhe ta trajtojë me shqetësim numrin e madh ose shtimin e madh të detyrimeve kontingjente, përkatësisht te palët paditëse, që janë operatorët ekonomikë për shkëputjen e kontratave në mënyrë të njëjanshme nga ana e Komunës. Po ashtu, Zyra e prokurimit duhet të ketë kujdes gjatë trajtimit të këtyre kontratave dhe t'i marrë për bazë edhe shumat që po i humbim nëpër gjykata, duke mos i trajtuar me efikasitet këto lëndë.

Agim Gashi fillimisht ngiti një çështje, duke thënë se kemi tri raporte në vijimësi. Është raporti buxhetor vjetor 2018, pastaj kemi vendimin për bartjen e buxhetit dhe reportin tremujor. Nëse kthehemë në aspektin analistik dhe e analizojmë, vlerat e fundit të këtyre raporteve të mjeteve të bartura, të dhënrat nuk përpushten dhe sot del se buxheti për të gjitha kategoritë ekonomike 2019 është planifikuar në vlerë 111 milionë euro. Ky është formulim gabim, ky nuk është planifikuar 111 milionë euro, është planifikuar 87 milionë euro dhe iu ka shtuar bartja. Raportet buxhetore dhe pasqyrat financiare në raportet buxhetore, duhet të kenë lidhshmëri, kontinuitet dhe përputhshmëri të plotë të pasqyrimit financiar me pasqyrat financiare. Nëse i analizojmë këto tri dokumente, shohim se 1 milion e 711.000 euro nuk figurojnë, nuk janë këtu, dhe si mund ta miratojmë këtë raport!

Sa i përket realizimit të të hyrave krahasuar me mundësitë buxhetore që janë të ulëta, këtu i kemi disa kategori, ku të hyrat kanë pasur mundësi të rriten, siç janë menaxhimi i sipërfaqeve publike dhe arkëtimi i mjeteve. Po ashtu, sa i përket shpenzimeve, duhet ta them se kjo vlerë e shpenzimeve të mjeteve, sidomos tek investimet kapitale dhe subvencionet, as 1% nuk e kanë arritur shkallen e shpenzimeve. Ky është dështim në qeverisje, është dështim i jashtëzakonshëm, sepse nëse vazhdohet me çfarëdo parametri analistik në qoftë se analizojmë, do të shohim se mjetet e mbeturës në fund të vittit do të dyfishohen dhe nuk do të mund të shpenzohen, për arsy se nuk është nisur mirë e mbar kjo punë.

Egzon Azemi tha se në vitin 2017, të hyra nga taksa për shfrytëzimin e sipërfaqes publike janë 99.699 euro, në vitin 2018 ka një rënje drastike, vetëm 47.953 euro, e për më keq në tremujorin e viti 2019 rënia është edhe më e madhe, me 21.990 euro, pra është e njëjtë hapësirë, është i njëjti qytet, mirëpo të hyrat tash janë skandalozë. Shihet se ka rënje te taksat

për leje ndërtimi, po ashtu tek mirëmbajtja e ndërtesave, përfshirë institucionet kulturore dhe sportive, mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve, përfshirë larjen, mirëmbajtën e kanalizimeve, ku as një cent nuk është shpenzuar për këto kategori.

Nëse shohim tek Drejtoria e Investimeve Kapitale, vetëm kategoritë të dëshmojnë për punën apo me saktë mos punën që është bërë në këtë drejtori. Nga 28 pika të paraqitura, vetëm për 2 nga këto 28 pika janë shpenzuar mjete.

Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike nga 24 kategori, vetëm në 5 ka shpenzuar mjete. Gjithsesi vlen të përmendet rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve, ku në shumë lagje të kryeqytetit ka kërkesa dhe ankesa nga qytetarët, edhe pse janë në dy kategori, rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve, diku janë të ndara 200.000 e tjetrën 50.000 euro. Në asnjëren prej tyre as edhe një cent nuk shpenzohen për rregullimin apo mirëmbajtën e tyre.

Po ashtu, edhe te Drejtoria e Arsimit, ku janë ndarë mjete si për renovime të sallave, për furnizim me kabinete, furnizim me libra, dhe në këtë tremujorin e parë nuk është shpenzuar asnjë cent nga ato mjete.

Arbenita Murseli theksoi se sa i përket këtij raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2019, disa prej drejtorive kanë arritur me shpenzuar afërsisht 10% të buxhetit të tyre dhe arsyja mund të jetë se në sezonin e dimrit është kohë shumë e papërshtatshme për të investuar në shumë projekte.

Kisha kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta bëjë zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në fshatin Tenezhdoll, pra në përgjithësi në zonat rurale, pasi që po ndikon tek siguria e banorëve. Po ashtu, edhe tek trajtimi i kafshëve endacake, edhe pse janë shpenzuar afërsish 16.000 euro, unë kisha dashur me pa ndonjë raport se çka është bërë në këtë drejtim, çfarë strategje është përdorur nga drejtoria përkatëse, duke e parë që qentë vazhdimisht po shtohen dhe rreziku është duke u bërë çdo herë më i lartë.

Nol Nushi theksoi se ky është raport i tremujorit të parë, dhe s'është e mundur që në këtë tremujor të harxhohen të gjitha mjetet përnjëherë. Po ta bëjmë një krahasim me periudhën paraprake, shihet se në disa drejtori ka rritje të përqindjes në shpenzimin e mjeteve buxhetore. Sa i përket subvencioneve, ato nuk shpenzohen kurrikund në tremujorin e parë, pasi që kanë të bëjnë me shpallje, pra është një proces që zgjat.

Eman Rrahmani tha se kur i shohim shifrat e shpenzimit të buxhetit, sidomos të investimeve kapitale, ku 2% është shfrytëzuar buxheti vitin e kaluar e kanë tepruar 25 milionë euro, kjo e tregon edhe punën edhe gjithçka që është bërë në këtë drejtori.

Po ashtu, kërkoj të dijë arsyen se pse nuk kanë përfunduar projektet për ndërtimin e parqeve në disa zona të qytetit e që kanë qenë në projekt për realizim. Për këtë kerkoi një përgjigje nga drejtoresha e drejtorisë.

Gjithashtu, edhe te Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave ka një shpenzim minimal të mjeteve, kështu që kjo tregon punën që është bërë. Është për të ardhur keq edhe prej qytetarëve me këtë bllokim të Prishtinës qysh është bërë.

Shefki Gashi ngriti një shqetësim, duke thënë se është e habitshme se si mund të bëhet që ky buxhet është rreth 112 milionë euro, e Komuna e Prishtinës me i lënë 26 vendbanime të Gollakut pa ujë të pijshëm! Unë këtë shqetësim do ta ngriti derisa të jem anëtar i këtij Kuvendi dhe derisa tă shoh që mbërriti rrjeti i ujësjellësit edhe në ato zona. Sa i përket buxhetit të paraparë për Drejtorinë e Bujqësisë, shihet se prej atij buxheti asnje cent nuk është shpenzuar, pra shihet se bujqësia është lënë krejtësisht anash.

Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, tha se kjo drejtori është krijuar rishtazi, në qershor të viti 2018, dhe rrjedhimisht ato parqe kanë filluar të ndërtohen nga Drejtoria e Investimeve Kapitale. Dy prej parqeve janë në ndërtim e sipër, parku në lagjen "Arbëria" dhe në lagjen "Matit 1". Sa i përket ndërtimin të parkut në lagjen "Kodra e Trimave", për shkak të kontesteve pronësore janë ndaluar punimet. Në momentin e sqarimit të çështjeve pronësore, do të vazhdojmë me punimet për ndërtimin e atij parku.

Mimoza Sylejmani tha se në lagjen "Kodra e Trimave", afér shkollës "Hilmi Rakovica", është duke përfunduar projekti zbatues – ideor, ku dhe do të procedohen në Prokurim. Po ashtu, edhe në Prugoc është projekti ideor për ndërtimin e një parku, por duhet pritur derisa të bëhet projekti zbatues.

Leonora Shabani-Bajraktari theksoi se në raport është dashtë të pontencohen se në cilat shkolla është bërë vendosja e kamerave të sigurisë, mandej rikonstruktimi dhe gëlqerosja e tyre, gjithashtu edhe rrethojat e oborreve të shkollave, ndërtimi i sallave etj. Ajo kërkoi të dijë rreth një konkursi për pranim të një kuadri të mësimit klasor në shkollen "Emin Duraku", që është shpallur nga Drejtoria e Arsimit në vitin 2018, dhe sot ka filluar punën një mësuese nga Suhareka, pa pasur përvojë pune, dhe nuk është nga komuna e Prishtinës. Unë e di që në komunën e Prishtinës kemi kuadro, sidomos të mësimit klasor, dhe nuk janë të punësuara. Do të doja të merrja një përgjigje nga kryetari, Burimet njerëzore, apo nga drejtoresha e Arsimit se si është punësuar kjo kandidate.

Për pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Valbona Makolli** drejtoreshë.

Kryesuesi konstatai se më 15 vota për (me votën e dyfishtë të kryesuesit), 14 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM 1).

Pika e katërt

Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës.

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës, të pranishmit në pikë të shkurtra i informoi Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizmit.

Egzon Azemi tha se sa i përket çështjes së planifikimit për parkingjet e reja dhe shtigjet për bicikleta, të parapara për vitin 2019, ka kaluar pothuajse katërmujori i këtij viti e ende nuk është shpenzuar aspak buxhet. Gjithashtu, kërkoi të dijë se cilat kanë me qenë lagjet dhe a ka me dalë edhe në diskutim publik ky propozimvendim edhe nëpër lagje, apo vetëm në sallën e Kuvendit ku ftohen qytetarët. Kishte me qenë mirë që ky plan me u prezantuar në secilën lagje të qytetit, që edhe banorët me u njoftuar më konkretisht me specifikat e lagjeve të veta.

Agim Gashi kërkoi të dijë se ky plan a ka një kosto, një paralogari, që pjesa esenciale e projektit sa do t'i kushtojë Prishtinës dhe në sa fazë do të zhvillohet deri në arritjen e atij standardi që synohet nga ky dokument. Pra, ky është një dokument që mundet të ndryshojë prej vitit në vit.

Nga prezantimi që na u bë këtu për Prishtinën e gjelbër, të pastër, me një transport të organizuar, por sidomos te transporti nuk e vërejta një transport gjithëpërfshirës në të gjitha vendbanimet e Prishtinës përmes procesit të subvencionimit të biletës.

Prishtina nuk organizon transportin e udhëtareve, nuk iu paguan biletën, sepse nuk ka kompani që e përballon atë kosto dhe nuk ka banor që e përballon çmimin e biletës.

Fiknete Bejta tha se sipas një paralogarie, Komuna duhet t'i ndajë diku rreth 13 milionë euro në vit për zbatimin e këtij projekti. Kompania projektuese duhet pas parasysh edhe gjithëpërfshirjen e transportit në të gjitha vendbanimet e Komunës së Prishtinës, duke i mundësuar përmes procesit të subvencionimit të biletës edhe atyre banorë nga periferia e fshatrave të Gollakut.

Për ta zbatuar këtë projekt të mobilitetit, duhet pasur vullnet gjithmonë, duhet pas parimin e mos diskriminimit, të gjithë qytetarët duhet trajtuar në mënyrë të barabartë.

Eman Rahmani tha se ky plan i mobilitetit fillimisht duhet kaluar këtu në Kuvend, kurse në buxhet janë të planifikuar 3 milionë euro për shpenzime në vitin 2019. Si do të ketë mundësi me bërë realizimin e këtyre mjeteve, kur ky plan nuk është ardhur në Kuvendin e Komunës për miratim dhe tash po del në diskutim publik.

Po ashtu, ne kërkojmë që dëgjimet publike të bëhen në secilën lagje, ose të paktën lagjet kryesore, ku mund të marrin pjesë edhe qytetarët edhe kushdo me interes, për shkak se deri me tash praktikat kanë treguar që organizime të tillë në objektin e Komunës kanë dështuar.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Burbuje Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 37 për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Vjosa Hamiti - Krasniqi kërkoi që të harmonizohen metrat katorre në propozimvendim dhe në vendim, pasi që në propozimi është 9 m², ndërsa në vendimi është 4 m².

Leonora Shabani - Bajraktari tha se pse ne si Komunë çdo herë japim parcela falas, kur dihet që KEDS-i është kompani private edhe mundemi me iu kërkuar qira për shfrytëzimin e parcelës, dhe nga ato mjete do të ishte krijua një fond që do t'i dedikohej shërbimeve në shkolla.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 2 kundër, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami)Sogojeva.

Vjosa Hamiti- Krasniqi tha se në këtë material mungon një faqe e dokumentit të pronës, në të cilën paraqitet barra apo hipoteka, andaj kërkoi sqarim për këtë.

Lidhur me çështjen e ngritura nga znj. Hamiti- Krasniqi, Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 7 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami)Sogojeva.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të Visar Sylejmanit.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në të Visar Sylejmanit.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Azemine (Hamit) Gashit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Azemine (Hamit) Gashit.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullorës për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Lidhur me Propozimvendimin për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, të pranishmit në pikat të shkurtra i informoi Premtime Preniqi, koordinatore për Njësinë e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore.

Agim Gashi bëri vërejte në nenin 5 të kësaj rregulloreje, duke thënë se është dashtë t'i shtohet edhe: “ ... me vendim, Asambleja komunale formon komisionet”.

Me vërejtjen e dhënë nga z. Gashi, që të inkorporohet në tekstin final, kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për, u miratua Vendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullorës për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Pika e dymbëdhjetë

Propozim vendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës.

Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, tha se komunat janë të obliguara dhe përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik, prandaj gjithmonë duhet vlerësuar

gjendjen shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre. Mjetet e mbledhura nga të hyrat vetanake dhe bashkëpagesat për shërbime shëndetësore, janë para publike dhe trajtohen sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, përgjegjësitë dhe rregullat financiare të thesarit sipas UA 04/2007.

Dita ditës, ofrimi i shërbimeve shëndetësore për banorët jorezidentë të komunës së Prishtinës po del të jetë një sfidë e madhe, duke ndikuar edhe në buxhetin e shërbimeve shëndetësore të qasshme dhe cilësore për banorët e komunës së Prishtinës. Në anën tjetër, shumë qytetarëve të Komunës së Prishtinës ju privohet e drejta për të marrë shërbime shëndetësore në kohën e duhur, por edhe duke u humbur koha e profesionistëve shëndetësorë të institacioneve shëndetësore publike për banorët jorezidentë të komunës së Prishtinës.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se shëndetësia financohet nga granti i Shëndetësisë, i cili na vjen nga niveli qendror, dhe ky grant i Shëndetësisë thotë se Prishtina i ka 200.000 banorë. Pra, ne marrim buxhet të bazuar në faktin që i kemi 200.000 banorë, ndërsa 60% të pacienteve në Qendrën Stomatologjike të Komunës së Prishtinës janë të Komunës së Fushë-Kosovës, Obiliqit, Lipjanit dhe komunave të tjera, dhe 40% janë të komunës së Prishtinës. Nuk po flasim për shërbimet emergjente që i ofron Qendra e Mjekësisë Urgjente, po flasim për analiza laboratorike, po flasim për shërbime të cilat nuk janë urgjente. Në qoftë se Komuna e Fushë-Kosovës i ka ambulancat e veta, atëherë me çfarë arsyetimi ne i shpenzojmë parat e taksapaguesve për ta subvencionuar një shërbim që duhet ta ofrojë Komuna e Fushë-Kosovës apo e Obiliqit. Ne jemi kryeqytet, dhe për këtë tash marrim grant shtesë, por këtu kemi të bëjmë me një kompetencë e cila është e jona, ku edhe komunat tjera i kanë të njëjtë. Neve na vijnë qytetarë si rezultat i shërbimeve më të mira dhe për shkak të faktit që kemi material shëndetësor, por po e them këtë e paguajmë nga paratë e taksapaguesve të Prishtinës.

Agim Gashi shprehi mendimin se po të ngarkohet me taksë një njeri i pafajshëm, qytetar, pse sëmuret, për shkak të kësaj ose asaj, mua po më duket jo humane.

Ta shtyjmë këtë dhe ta orientojmë kërkësen tonë në një presion funksional në Qeveri, në mënyrë që të rregullohet ky problem. Do të ishte mirë që edhe Qeveria të gjejë një rrugë ligjore që ta rregullojë këtë fushë.

Arbër Vokrri tha se një prej mënyrave më efikase në mungesë të efektshmërisë së rezultateve gjatë provimit të mënyrave tjera për me e reduktuar pak ketë fluks, mbase do të ishte rritja e tarifave për të gjitha shërbimet, pavarësisht a është fjala për qytetarë rezidentë apo jorezidentë.

Ne si kryeqytet, në bazë të Ligjit për Prishtinën marrim për obligim, bashkë me fonde shtesë, që me trajtuar edhe raste që vijnë në kryeqytet prej komunave të tjera, kështu që duhet të tregojmë edhe pak vëmendje në këtë aspekt, edhe mbase do të duhej në një periudhë jo të largët, që të shqyrtohet mundësia për ta trajtuar më në hollësi këtë çështje.

Suzan Kika tha se Prishtina ka probleme të mëdha me banorë jorezidentë dhe këtë problem duhet trajtuar në mënyrë praktike dhe operative, duke filluar që nga bashkësítë lokale. Sipas regjistrimit, Prishtina ka më pak se 200.000 banorë, e në fakt shërbim marrin 500.000 banorë, gjë që është rrrethanë që krijon probleme në planifikim dhe shërbime. Andaj propozoj që për çdo shërbim të paguhen çmime të veçanta, duke përfshirë edhe shërbimet mjekësore për të gjithë ata pacientë që nuk janë rezidentë në Prishtinë.

Sami Boroci tha se po t'i referohemi nenit 4 të këtij propozimvendimi, më tingëllon pak diskriminuese edhe mendoj që do të duhej me u diskutuar, pasi që propozimi për rritjen trefish të taksës për banorët jorezidentë, konsideroj se është i lartë dhe unë këtë propozimvendim nuk do ta votoj. Propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjeter, në mënyrë që të shohim forma të tjera se si të veprohet më tutje.

Egzon Azemi tha se kjo pikë duhet të shtyhet për diskutim, për shkak se nuk ka kurrfarë prezantimi as në këtë dokument këtu. E kemi p.sh. çmimoren sa është dhe sa do të bëhet për relacionin Prishtinë -Tiranë për përdorimin e auto-ambulancës. Për çështjen e banoreve jo rezidentë të Prishtinës nuk kemi asnje informacion, përvèç këtyre dy neneve, ku thuhet se do të ketë tarifa trefish më të larta. Është shumë e padrejtë të bëhet një gjë e tillë. Prishtina është kryeqytet, nuk duhet ta trajtojmë Prishtinën si Fushë-Kosovën, apo si Obiliqin. Secili qytetar që vjen në Shtëpitë e Shëndetit për të kërkuar një shërbim, vjen për nevojë, ata që kanë para shkojnë në ordinanca private, ose iu vjen mjeku në shtëpi. Pra, këtu kryesisht vijnë ata që janë në gjendje më të ulët ekonomike, në tërë këtë depresion shoqëror, andaj kërkoj që ta shtyjmë këtë dhe mos ta votojmë këtë propozimvendim.

Nol Nushi theksoi se Prishtina si kryeqytet nuk mund t'i lirojë komunat të tjera nga përgjegjësitë që i kanë ndaj qytetarëve të tyre. Pra, me këtë logjikë që ne u themi komunave të tjera se ju mos punoni asgjë se ne i kryejmë punët e komunave të tjera, është logjikë që i dëmonton vetë ato komuna dhe ata qytetarë. Edhe rritja e tarifave nuk duhet të bëhet për zvogëlim të fluksit, sepse nuk zvogëlohet fluksi detyrimisht vetëm duke rritur tarifa, nuk është kjo logjika, sepse ai që shkon në spital, nuk shkon për dëshirë, ai ka me marrë aty një Shërbim, pavarësisht se sa i kushton. Do të ishte mirë të bëhet presion me subjektet politike, që me i përmirësuar kushtet e QMF-ve dhe në komunat përreth Prishtinës dhe ato që janë më larg, mos me u bërë praktikë, sepse kështu ngarkohet edhe stafi mjekësor.

Eman Rahmani tha se është për t'u habitur se qysh mundohet me u zgjidhur një problem i tillë me bariera ndaj qytetarëve, të cilët më së shumti kanë nevojë për shërbime. Nëse nisemi nga kjo praktike, atëherë çfarë kushtesh ose barrikada iu kemi qitura punëtoreve që i punësoni nga të gjitha komunat në Komunën e Prishtinës, çfarë kushtesh ju keni qitura drejtorëve, a duhet me qenë tri herë më të mençur se të Prishtinës për me u bërë drejtor në Komunën e Prishtinës?! Si ka mundësi me u diskriminuar ai që ka nevojë për me u kontrolluar, e bllokoni atë, kurse punësimet i bëni nga të gjitha qytetet e Kosovës?!

Haki Dragusha theksoi se sikur Ministria e Shëndetësisë ta kishte kryer punën e vetë me sistemin informativ shëndetësor, ne nuk e kishim qitur as në rend dite, sepse ishin eliminuar vetë qytetarët e qyteteve tjera. Qëllimi i kësaj pike nuk është që t'u merren para qytetarëve, por edhe që t'i edukojmë qytetarët, duke u zbatuar koncepti i Mjekësisë Familjare. Edhe unë jam kundër nenit 4, mirëpo kjo e ka qëllimin e mirë, sepse këta pacientë do të ridestinohen në QMF-të e tyre dhe do ta zgjedhin mjekun e vetë, që do të përkujdesen më mirë për shëndetin e tyre.

Shefki Gashi shprehu mendimin se propozimi për caktimin e taksës për qytetarët jorezidentë të komunës së Prishtinës është diskriminuese, andaj propozoi që ky propozimvendim, me disa nga ato pikat e tjera që janë të rëndësishme, si shërbimi i transportit, të përpunohen dhe t'i shqyrtojmë edhe një herë.

Drilon Pireva tha se si pasojë e mospunës së krytarëve të komunave të tjera dhe shërbimeve jo cilësore të QMF-ve në ato komuna, qytetarët e atyre komunave detyrohen që të marrin shërbimet mjekësore në komunën e Prishtinës. Ne duhet ta gjejmë mundësinë se si mund të marrim masa për t'i shtyrë banorët jo rezidentë me u regjistruar në Komunë, po mendoj që duhet me gjetur forma të tjera që ata me qenë edhe taksapagues në Komunën e Prishtinës, jo me i faturuar këtë çmim ose këtë faturë për qytetarët jorezidentë të Prishtinës.

Fikneta Bejta theksoi se sa i përket hallexhinjve, ashtu si u shpreh një parafolës, te neni 5 veç është specifikuar kush lirohet prej këtyre pagesave.

Fadil Gashi u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendimi, mirëpo do të ishte ide edhe më e mirë që gjithë ata që punësohen prej komunave të tjera, mos me mundur me u punësuar në komunën e Prishtinës, me pasur disa kritere, në veçanti ai që është prej Prishtinës me pasur përparësi ndaj kandidatëve nga komunat tjera.

Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se po t'i referohemi nenit 4 të këtij propozimvendimi, mendohet që tarifat të ngrihen trefish më shumë sesa që janë të përcaktuara në Udhëzimin administrativ. Për ta ndërruar këtë tarifë, fillimisht duhet me u ndërruar Udhëzimi.

Naime Osmani tha se jam kundër këtij vendimi, sepse është një lloj diskriminimi i qytetarëve, i banorëve të Kosovës, dhe përderisa nuk ka kritere, nuk parashtrohen kriteret për të punësuarit, atëherë edhe unë nuk e votoj këtë propozimvendim.

Arbenita Murseli u shpreh se, sa i përket këtij propozimvendimi për caktimin e tarifave për personat jo rezidentë, ndoshta në njérën anë mund të shihet si e arsyeshme, pasi që po ka mbingarkesë të pacientëve jo rezidentë, e këtë më së miri e dinë stafi i Mjekësisë Familjare. Mirëpo, në anën tjetër, me sa jam në dijeni, ka gjasa të jemi në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi publike dhe Ligjin për të drejtat e njeriut, sepse nuk është e drejtë

me caktuar tarifa për ofrimin e atyre shërbimeve. Si rrjedhojë, kjo do të ishte diskriminuese.

Halim Halimi tha se dispozitat e nenit 4 të këtij propozimvendimi janë të kundërligjshme dhe nuk kemi nevojë ne të marrim vendime të kundërligjshme, që bien në kundërshtim me Ligjin mbi shëndetësinë, Ligjin mbi diskriminim dhe Udhëzimin administrativ. Nuk guxojmë ne si Komunë me bërë dallime për qytetarët e komunës së Prishtinës, derisa të jenë këto ligje në fuqi. Shërbimet mjekësore parësore janë të obligueshme për të gjithë qytetarët, pa bërë asnjë përjashtim se nga cili qytet vijnë ata. Si Grup parlamentar, nuk do ta votojmë këtë propozimvendim.

Bujar Gashi, drejtor, tha se neni 4 ka të bëjë me shërbimet jo urgjente, me shërbimet të cilat qytetarët mund t'i marrin në secilin qytet. Nuk është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi, as me Ligjin për emergjencat, as me Udhëzimin administrativ. Shërbimet mjekësore emergjente në komunën e Prishtinës do të vazhdojnë me u ofruar për të gjithë qytetarët, si të Prishtinës, ashtu edhe për qytetarët jorezidentë të Prishtinës, si dhe për stafin ndërkombëtar.

Kryesuesi konstataoi se më 14 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim, nuk u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës.

Pika e katërmëbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje.

Kushtrim Sopa, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave:

1. Në pjesën periferike të lagjes "Arbëria", ndryshe e njohur si Përroi i Njelmët, fabrika e cila bën riciklimin e letrës, mbetjet ose mbeturinat e saj i ka hedhur në përroskën e cila përbante ujë natyral, ndërsa tani hedhja e këtyre materialeve po shkakton dëme të mëdha ekologjike në atë pjesë. (Qytetarët e kësaj pjese të qytetit 4 herë kanë dorëzuar ankesat e tyre edhe me nënshkrime, mirëpo si duket kanë hasur në veshë të shurdhër).
A do të merren masa urgjente për këtë shqetësim të qytetarëve të pjesës së Përroit të Njelmët?
2. A do të merren masa për veturat të cilat parkohen përgjatë rrugës "Toni Bler" në drejtim të shkollës "Mehmet Gjevorë" në lagjen "Arbëria", ngase ato vitura të cilat parkohen gjatë tërë ditës në korsinë e djathë të rrugës dhe në trotuare, shkaktojnë bllokadë në komunikacion në atë pjesë? Gjithashtu edhe trotuaret bllokohen dhe fëmijët detyrohen të dalin edhe në rrugë për të shkuar në shkollë.

3. Pranë restorant "Panorama" në Zllatar, qytetarët shprehin shqetësimin se një banor i asaj pjesë po e shkel Planin e hollësishëm rregullues për atë zonë, ku parashihet ndërtimi i objekteve dhe shtëpive me P+1, po tanë ai vetëm se po e shkelë rregulloren e përcaktuar nga organet legislative të Komunës.
4. Banorët afër rrugës "Hamdi Mramori", e cila gjendet mes Muzeut të Qytetit dhe Xhamisë së Mesme, ankohen se banojnë në hapësira të vogla dhe të ngushta të banimit. A do të lejohen investime të ndryshme për banim kolektiv ose individual në atë pjesë?
5. A do të merren masa për parkimin e veturave në trotuaret e rrugës, e cila përshkon distancën nga objekti i MKRS (Shtëpia e sporteve) e deri tek varrezat e dëshmorëve, ku qytetarët e lagjes "Muhaxhirët" detyrohen që të ecin në rrugë dhe kanosen nga aksidentet e mundshme me pasoja prej me të ndryshmeve?
6. A do të rregullohet infrastruktura në rrugën "Sharri"?
7. A është rritur çmimi i tatimit në pronë, nëse po, përsë nuk janë njoftuar qytetarët për këtë ndryshim?
8. Rruga "1 Tetori", e cila lidh lagjen "Velania" me Parkun e Qytetit, është në gjendje të mjerueshme, qytetarët ankohen se ata paguajnë të gjitha obligimet e shërbimeve komunale me kohë, madje për vonesa eventuale penalizohen, ndërsa komunarët për mos rregullimin e infrasktrukturës rrugore arsyetohen me punimet e ndërtimeve të banesave kolektive në atë zonë.
Kur do të rregullohet ajo rrugë?
9. A do të përmirësohet ndriçimi publik në zonat e thella të qytetit, sidomos në parqet ekzistuese brenda qytetit dhe jashtë tij?
10. A do të merren masa për trajtimin e qenve endacakë, ngase ata tanë më veç se janë shfaqur në turma të mëdha të tyre në lagjet "Arbëria", "Tophane", "Qafa", "Kodra e Trimave" e shumë pjesë të tjera të qytetit, ku sinqerisht qytetarët kanosen nga rreziqet prej kafshimeve të mundshme e deri në fatalitet të fëmijëve të vegjël?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të kontratave, tha se aty ku po bëhen ndërtime, po kemi dëmtime të rrugëve, do të thotë për arsy që kapaciteti i këtyre nuk po mundet me e përballuar peshën e madhe. Afër rrugës "Gazmend Zajmi", aty ka ndërtime të jashtëzakonshme dhe ka ndërtime kolektive, është detyrim me pas një distance të rrugës dhe neve kjo na mundëson zgjerimin e rrugës. Momentalisht, një situatë të tillë e kemi edhe në lagjen "Pejton", do të thotë me plan të hollësishëm rregullues aty parashihet zgjerimi i rrugëve.

Naime Osmani, për Kryetarin e Komunës dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

1. Një banor i komunës së Prishtinës pyet se deri kur do vazhdojë kryetari i Komunës me punësimë jashtë komunës së Prishtinës dhe mos shpalljen e konkurseve, dhe a do të shpresojmë që ne do të punësohem ndonjëherë?

Faqe 18 nga 19